



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.101/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë e paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega Drenas, me objekt vendosje e posterit të kandidatit për kryetar të komunës i subjektit politik LDK, në hapsirë publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës Drenasit të datës 4.12.2016, në seancën e panelit të mbajtur me 03.12.2016, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës KDI, Anr.101/2016, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimini më gjobë në vlerë prej 1200 (njëmijedyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë me datën 02.12.2016, në të cilën pretendohet se me datë 01.12.2016 rreth orës 14:00, në Sheshin kryesor të qytetit, monitoruesi i tyre ka hasur në një poster të ngjitur në hapsirë publike, të kandidatit për kryetar të komunës, të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Parashtruesi i ankesës, parregullsisë së evidentuar i ka bashkangjitur si dëshmi një foto si dhe një CD në të cilën gjendet një foto të ngjashme me foton e printuar, duke pretenduar se është bërë shkelje e dispozitës ligjore të nenit 33 paragrafi 1 pika b) të ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi Subjektin politik LDK lidhur me ankesën e datës 02.12.2016, të parashtruar nga KDI, si dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankesë deri më datë 03.12.2016 në ora 12:00.

Subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 3.12.2016, ka theksuar se “në këtë rast persona të paidentifikuar, kanë larguar posterët, të cilët ishin vendosur nga ekipet tona në vende të lejueshme, duke i vendosur pastaj në vende të palejueshme”.

Po ashtu në përgjigjen në ankesë subjekti politik LDK, thekson se “këtë veprim e kemi konsideruar si provokim, dhe si veprim të montuar, për këtë arsye LDK, është angazhuar që urgjentisht posteret tanë të gjendur në vende të palejueshëm, e të cilët nuk janë vendosur nga ne të hiqen”. Me tutje thekson se “ekipi i ynë i monitorimit, i cili ka qenë gjatë gjithë kohës në teren, dhe e ka vërejtur para se KDI, ta vërente dhe të bënte foton, i ka marrë të gjitha masat që të bëj largimin e posterit të Kandidatit, tonë për kryetar Komune në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në Drenas, që mbahen me 04.12.2016”. LDK, po ashtu thekson se “posteri i vendosur i kandidatit tonë në vend të papërshtatshëm siç e ka dokumentuar edhe ankuesi, konstatojmë edhe njëherë se është vendosur nga persona të paidentifikuar dhe se i njëjti, është mënjanuar nga ekipi ynë i monitorimit nga vendi i apostrofuar”.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve në procedurë, dhe të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se **ankesa është e bazuar** për këto arsyet:

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për kryetar të komunës së Drenasit, Bedri Nika i subjektit politik LDK, është i vendosur në hapsirë publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, Nr.03/L-073, si dhe Ligjit për Zgjedhjet Lokale Nr.03/L-072, që përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktivitetave të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese, konstatoi se si rrëthanë rënduese është se subjekti politik LDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posteri i kandidatit për kryetar të komunës nga subjekti politik LDK, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Drenasit, ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e tyre. Prandaj pretendimet e palës përgjegjëse nuk janë bërë të besueshme pasi i njëjti pretendim nuk është argumentuar apo provuar me anë të provave. Ndërsa si rrëthanë lehtësuese PZAP-i, mori se subjekti politik LDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar,

ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterin nga vendi ku ka ndodhur shkelja.


Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, PZAP-i, konstaton se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur nen 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit të saj për kryetar të komunës së Drenasit, është i vendosur në hapsirë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik LDK që ka ndërrmar për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.101 /2016 më datën 03.12.2016.

**Kryesuesi i Panelit
Dr.sc Rafet Haxhaj**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.



A handwritten signature in blue ink is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text 'Gjykata e Pejesë' and 'Ankesa' around its border, with 'Rafet Haxhaj' in the center. The signature is fluid and appears to be 'Rafet Haxhaj'.